

KONTRATË SHITJE KUOTASH

Lidhur sot më 19.05.2023 in Tiranë, mes palëve të mëposhtme nënshkruhet kjo kontratë për shitjen e kuotash si më poshtë vijon:

Z.Marin Shpata, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 26.02.1983, banues në Tiranë, Rruga Budi, 2, Vila Nr.8, mbajtës i kartës së identitetit me nr. Personal I30226131V, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar që këtu e më poshtë do të quhet **“Shitësi”**

Dhe

“Unlimited Media” SH.P.K, identifikuar nga NUIS: K91513004S me seli qendrore në adresën: Rr. "Rezervat e Shtetit", Lundër 1, Farkë, Tiranë, e regjistruar pranë QKB-së, përfaqësuar rregullisht nga Administratorja Znj.Selena Kurti, e cila ka tagra të plota për të nënshkruar këtë kontratë, që këtu e më poshtë do të quhet **“Blerësi”**.

Palët bazuar në nenin 73/1/b të Ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” – i ndryshuar, nenin 705 dhe vijues të ligjit nr. 7850 dt. 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” dhe statutin e shoqërisë “e-LAVA” SHPK, lidhin këtë “kontratë për shitblerje kuotash” si më poshtë vijon:

Neni 1 Objekti i kontratës

1.1. Objekti i kësaj kontrate është shitja nga Shitësi tek Blerësi 1 (një) kuotë të kapitalit të shoqërisë “e-LAVA” SH.P.K që përfaqëson 50% (pesëdhjetë përqindë) të kapitalit të shoqërisë që zotërohet aktualisht nga Shitësi, dhe regjistrimi i këtij kalimi në Regjistrin Tregtar Shqiptar.

Neni 2 Çmimi i shitjes

- 2.1 Çmimi i shitjes së 50 % të kuotave të kapitalit të shoqërisë “e-LAVA” SHPK nga Shitësi tek Blerësi është në vlerën nominale prej 50,000 ALL (pesëdhjetë mijë lekë).
- 2.2 Palët deklarojnë se çmimi i shitjes së kuotave i përcaktuar në nenin 2 të kësaj kontrate, do të likuidohet prej blerësit me transfertë bankare, 5 (pesë) ditë nga nënshkrimi i kësaj kontrate.
- 2.3 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, pronësia mbi kuotat/pjesët e kapitalit të shoqërisë bëhet si më poshtë:

- **“Unlimited Media ” SH.P.K** zotëron 50% të kuotave të kapitalit;
- **Z. Marin Shpata** zotëron 50% të kuotave të kapitalit.

Neni 3 Detyrimet dhe garancitë e Shitësit

3.1 Shitësi garanton se pjesët/kuotat e tij në kapital, objekt i kësaj kontrate, nuk janë lënë peng, në dorëzani apo rënduar me ndonjë lloj tjetër barre siguruese dhe Shitësi është i vetmi pronar që gëzon të drejta të plota mbi këto pjesë/kuota të kapitalit.

- 3.2 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësi heq dorë nga të drejtat e tij mbi kuotën/pjesën e kapitalit, objekt të kësaj kontrate, të drejta të cilat i transferohen Blerësit
- 3.3 Shitësi do të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme për të garantuar zbatimin e kësaj kontrate dhe respektimin e të gjitha detyrimeve që lidhen me këtë.

Neni 4
Detyrimet dhe garancitë e Blerësit

- 4.1 Blerësi do të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të garantuar pjesën e tij në zbatimin e kësaj kontrate dhe respektimin e të gjitha detyrimeve që derivojnë nga kjo Kontratë.

Neni 5
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 5.1 Kjo kontratë hartohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 5.2 Çdo mosmarrëveshje mes palëve do të zgjidhet me mirëkuptim, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 6
Gjuha e Kontratës

- 6.1 Kjo kontratë është hartuar në dy kopje në gjuhën shqipe, të dyja të njëvlershme dhe origjinale.
- 6.2 Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

SHITËSI

Z. Marin Shpata

MARIN SHPATA




BLERËSI

"Unlimited Media" SH.P.K.

Përfaqësuar nga

Znj. Selena Kurti



Unlimited Media (UM) sh.p.k.

NUIS: K91513004S